



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 102/5 prot.

Tiranë, më 15.07.2020

VENDIM
Nr.62, datë 15.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 221, DATË 27.12.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 221, datë 27.12.2019, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë 2018 dhe 6-mujorit të parë 2019, ndaj nëpunësit *****”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të ardhur nga nëpunësi *****, regjistruar me nr.1268 prot., datë 15.07.2019, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është njohur me pretendimet e tij se procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2018, është kryer në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që pasqyron veprimet administrative të kryera në lidhje me procedurën e ndjekur të vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin në fjalë.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ, procesi është përmbyllur me Vendimin Nr.221, datë 27.12.2019, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë 2018 dhe 6-mujorit të parë 2019, ndaj nëpunësit *****”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, institucioni ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin Nr. 221, datë 27.12.2019, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, rezulton se:

1. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka marrë masat për përmirësimin e praktikave të vlerësimit të rezultateve në punë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil për nëpunësit civilë të këtij institucioni.
2. Për nëpunësin ***** rezulton se është plotësuar formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2018 dhe Janar - Korrik 2019, në përputhje me detyrat e lëna nga Komisioneri.
3. Nga ana e institucionit është konfirmuar se nëpunësi është regjistruar për të marrë pjesë në dy trajnime pranë ASPA-s, dhe, pas përfundimit të tyre, do të vijohet me kryerjen e vlerësimit të pjesshëm tremujor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 221, datë 27.12.2019, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë në kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë 2018 dhe 6-mujorit të parë 2019, ndaj nëpunësit *****”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 221, datë 27.12.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha